



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

---

## PROVIMI I LIRIMIT 2010

### SESION I

(I DETYRUAR)

### SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Gjuhë shqipe

*Udhëzime të përgjithshme:*

- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje, 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime, të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

## PJESA I

---

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë

---

Pyetja 6 2 pikë

**Model përgjigjeje**

Sportet nxisin krenarinë kombëtare, sepse:

- luhet himni kombëtar i vendit të fituesit përpara të gjithë njerëzve nga shumë vende të botës.
- ngrihet flamuri kombëtar i vendit të fituesit përpara të gjithë njerëzve nga shumë vende të botës.
- të gjithë njerëzit, nga shumë vende të botës, në atë moment, shikojnë fituesin dhe e kanë në qendër të vëmendjes, atë dhe vendin e tij.
- njerëzit që janë nga i njëjti vend me fituesin, ndihen krenarë për këtë, pasi bëhet fjalë për vendin e tyre.

**2 pikë** Nëse në përgjigje shkruan dy nga argumentet e dhëna më sipër, që mbështesin pohimin e dhënë.

**1 pikë** Nëse në përgjigje shkruan një argument që mbështet pohimin e dhënë.

**0 pikë** Përgjigja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

**Shënim**

*Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.*

---

Pyetja 7	D	1 pikë
Pyetja 8	A	1 pikë
Pyetja 9	B	1 pikë

**Pyetja 10 (A) 2 pikë****Model përgjigjeje**

- Fani nuk dëshiron të flasë me Budardin për aksidentin, pasi ai e di që shoku i tij ndihet në faj dhe i duket sikur e rëndon më shumë kështu.

**OSE**

- Fani nuk beson se ishte faji i Budardit, ndaj s'ka pse flasin për aksidentin.

**OSE**

- Fani mendon se ishte vetë fajtor, pasi nuk pati kujdes dhe kështu u aksidentua.

**OSE**

- Gjatë pushimeve, Fani si dhe të gjithë fëmijët, luajti pa kujdes dhe kështu u aksidentua.

**2 pikë** Nëse në përgjigje shpjegon pse Fani nuk dëshiron të flasë me Budardin për aksidentin DHE nëse shpjegon se cila ishte arsyeja që ai theu këmbën.

**OSE**

**1 pikë** Nëse në përgjigje shpjegon vetëm pse Fani nuk dëshiron të flasë me Budardin për aksidentin OSE shpjegon se cila ishte arsyeja që ai theu këmbën (njërën nga të dyja).

**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

**Shënim**

*Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk përafrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.*

**Pyetja 10 (B) 1 pikë****Model përgjigjeje**

- Fani dëshiron të bisedojnë në gjysmerrësirë, pasi kështu ndihet më mirë, më pranë shokut, biseda bëhet më intime, më e afërt dhe më e ngrohtë.

**OSE**

- Meqenëse ajo çfarë do t'i thotë shokut është paksa delikate, e ka më të lehtë t'ia thotë në gjysmerrësirë.

**OSE**

- Shpesh në gjysmerrësirë gjërat bëhen më të lehta për t'u thënë.

**1 pikë** Nëse shpjegon qartë pse Fani dëshiron të flasin në gjysmerrësirë.

**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

## PJESA II

## Pyetja 11 (A) 2 pikë

## Model përgjigjeje

Jeta e Fanit pas aksidentit ka ndryshuar në disa drejtime:

- ai nuk shkon më në shkollë.
- ai nuk luan dot më me shokët.
- ai nuk merr pjesë në aktivitetet shkollore.
- ai rri tërë ditën në shtëpi.
- ai nuk merr pjesë në ngjarjet e ndryshme që ndodhin në shkollë.
- ai është detyruar të përballojë edhe dhimbjen që s'e kish provuar më parë.

**2 pikë** Nëse në përgjigje shkruan dy momente që tregojnë se jeta e Fanit pas aksidentit ka ndryshuar.

## OSE

**1 pikë** Nëse në përgjigje shkruan vetëm një moment që tregon se jeta e Fanit pas aksidentit ka ndryshuar.

**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

*Shënim*

*Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.*

## Pyetja 11(B) 2 pikë

## Model përgjigjeje

- i qëndronte te koka
- e mbajti Fanin me kujdes
- me një përkujdesje amtare
- po i jepte shokut të vet për mbështetje supin e tij
- çfarë nuk bëri tjetër për t'i ardhur në ndihmë
- ia fërkoji me maja të gishtave
- nuk vura gjumë në sy për tërë natën
- eja të shtrihesh tani

**2 pikë** Nëse shkruan dy shprehje ku duket përkujdesja e Budardit ndaj Fanit.

**1 pikë** Nëse shkruan një shprehje ku duket përkujdesja e Budardit ndaj Fanit.

**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

**Pyetja 12 (A) 1 pikë****Model përgjigjeje**

- Ndjenjën e fajit e shkakton shqetësimi që po u shkakton të tjerëve. Ata janë të detyruar të ngrihen natën, orë e pa orë për të.
- Kjo tregon se Fani është natyrë **e ndjeshme** (e kujdesshme). Ai nuk mendon vetëm për dhimbjen e tij, por edhe për shqetësimin dhe telashet që mund t'u shkaktojë njerëzve të tjerë.

**2 pikë** Nëse në përgjigje shkruan se çfarë e shkakton ndjenjën e fajit te Fani DHE se ç'tregon kjo për natyrën e tij.

OSE

**1 pikë** Nëse në përgjigje shkruan se çfarë e shkakton ndjenjën e fajit te Fani OSE se ç'tregon kjo për natyrën e tij (një nga të dyja).

**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

**Shënim**

*Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.*

**Pyetja 12 (B) 1 pikë****Model përgjigjeje**

- Marrëdhënien midis dy djemve e bën të veçantë mirëkuptimi dhe afërsia që ata kanë me njëri-tjetrin.
- E bën të veçantë të qëndruarit pranë në rast nevoje dhe mbështetja te njëri-tjetri.
- Ata flasin hapur, çiltër dhe i besojnë njëri-tjetrit.
- Kjo tregon se miqësia nuk është vetëm lojë dhe argëtim, por edhe përkujdesje, mirëkuptim dhe ngrohtësi.

**Ilustrime:**

- Budardi i qëndronte te koka (ngrohtësi).
- Ata vazhdonin të bisedonin kokë më kokë (flasin hapur, çiltër).
- E mbajti Fanin me kujdes (ndihmë, përkujdesje).

Etj

Në të gjitha rastet e përgjigjeve, nxënësit duhet të theksojnë se kjo është një miqësi që mbështetet në përkujdesje dhe ngrohtësi dhe jo vetëm në argëtim dhe lojë.

**2 pikë** Nëse argumenton plotësisht se çfarë e bën të veçantë marrëdhënien midis dy shokëve.

**DHE**

**1 pikë** Ilustrimi

**OSE**

**1 pikë** Nëse argumenton pjesërisht miqësinë e veçantë midis dy djemve.

**DHE**

**1 pikë** Ilustrimi

**OSE**

**1 pikë** Nëse argumenton pjesërisht miqësinë e veçantë midis dy djemve, por s'ka ilustrim.

**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

**Shënim**

*Në rast se nxënësi jep vetëm një ilustrim pa asnjë argument, atëherë ai do të vlerësohet me 0 pikë.*

*Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk përafrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.*

Pyetja 12 (C)

1 pikë

1 pikë

Nëse nxënësi shkruan një titull të figurshëm për këtë histori, i cili të shprehë thelbin e saj.

0 pikë

Nëse titulli i zgjedhur nuk është i figurshëm, nuk shpreh brendinë e saj ose nuk ka përgjigje fare.

## PJESA III

Pyetja 13

1 pikë

1 pikë

D

Pyetja 14

2 pikë

1 pikë

qark: parafjalë

1 pikë

butë-butë: ndajfolje

Pyetja 15 C

1 pikë

Pyetja 16 (A)

1 pikë

1 pikë

tënd: përemër pronor

Pyetja 16 (B)

1 pikë

1 pikë

më: rasa dhanore

Pyetja 17

2 pikë

1 pikë

Mënyra: lidhore

1 pikë

Koha: e pakryer

Pyetja 18

1 pikë

Nëse shkruan një fjali ku paskajorja e foljes luaj (për të luajtur) është në funksion qëllimor.

Pyetja 19      A      1 pikë

Pyetja 20      2 pikë

1 pikë      **Kryefjala:** im vëlla

1 pikë      B      grup emëror

Pyetja 21      2 pikë

1 pikë      **Kallëzuesi:** vazhdonin të bisedonin

1 pikë      **Lloji:** kallëzues i përbërë foljor

**Shënim:**

Nxënësi do të marrë një pikë edhe nëse shkruan vetëm *kallëzues i përbërë*.

Pyetja 22      2 pikë

1 pikë      **bubulak:** përcaktor

1 pikë      **për shokët e klasës:** kundrinor i zhdrejtë me parafjalë

**Shënim:**

Nxënësi do të marrë 1 pikë edhe nëse shkruan vetëm kundrinor.

Pyetja 23 (a)      1 pikë

1 pikë      **Pjesa e nënrenditur:** *Kur pushimet po mbaronin*

Pyetja 23 (b) D      1 pikë

Pyetja 24      3 pikë

1 pikë      a. Vendosja e presjes pas fjalëve: reparte ushtarake të rregullta,

1 pikë      b. Shqipërinë e Veriut (Veriut me të madhe)

1 pikë      c. të pjesëtuar



**Pyetja 25 6 pikë**

Për pjesën të shkruajmë do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË****2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një letër ku argumenton pse personazhi i zgjedhur prej tij duhet të jetë pjesë e pikturës në murin e shkollës.
- shpreh qartë, përmes detajeve dhe shprehjeve të përzgjedhura, të veçantën e këtij personazhi.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: STRUKTURA****1 pikë**

- respekton elementet e strukturës së letrës:

hyrjen (vendosja e fjalëve hyrëse në një letër: lidhja midis shkruarit dhe lexuesit)  
zhvillimin  
përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

*Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.*

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI****1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- ka fjalor të pasur
- ka stil origjinal
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE****2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta
- ka saktësi drejtshkrimore